**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# <u>SKELETKURRIKULI</u>

## Për Drejtimin Mësimor

# MEKANIK

## Niveli I

**Kodi: F-I-18**

Miratoi:

MINISTRI

............................................

**Tiranë, 2018**

## Përmbajtja


**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor "Mekanik", niveli I.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin "Mekanik" niveli I.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I.

**III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

# I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Mekanik”, niveli I.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin **“Mekanik”, niveli I**, është ***“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar ose vetëpunësuar në veprimtari profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimet e detaleve dhe konstruksioneve mekanike, me mirëmbajtjen dhe riparimin e të makinave dhe pajisjeve mekanike”.*** Zhvillimit te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës në fushën e përpunimit të drurit që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës

# II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Mekanik”, niveli I.

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Mekanik”, niveli I.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Mekanik” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Mekanik”, niveli I.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “**Mekanik**” **niveli I**, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënit të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

## 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I

Me përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin **"Mekanik", niveli I**, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës për punime mekanike.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit të mekanikut.
- Të interpretojë skica, vizatime dhe dokumentacion teknik të punimeve mekanike.
- Të përgatitë skica dhe vizatime teknike që detaleve dhe nyjeve të thjeshta mekanike.
- Të kryejë matje dhe kontrolle mekanike me përdorimin e instrumentave përkatëse.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punime mekanike.
- Të kryejë punime të ndryshme axhusterie (limime, shpime, prerje, filetime, deformime plastike dhe zmerilime) me vegla dore.
- Të kryejë punime të thjeshta dhe mesatare të saldimit me hark elektrik dhe me gas.
- Të kryejë punime të zmontimit dhe montimit të nyjeve, mekanizmave dhe agregateve.
- Të kryejë punime të tornimit, të saktësisë mesatare.
- Të kryejë punime të frezimit, të saktësisë mesatare.
- Të kryejë punime të zdrugimit, të saktësisë mesatare.
- Të kryejë punime të ndërtimit të konstruksioneve metalike të thjeshta.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes së makinave industriale.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

## 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim profesional.
Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në ndërmarrje prodhuese dhe të mirëmbajtjes e riparimit në sektorin e mekanikës, ose mund te vetëpunësohet si mekanik ambulant, në këtë sektor të prodhimit dhe shërbimeve. Përsa i përket arsimimit të mëtejshëm, nxënësi ka mundësi të vazhdojë studimet në nivelin II të

arsimit profesional në një prej profileve të drejtimit mësimor "Mekanik" (si mekanik i kualifikuar). Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional edhe në nivelin III (teknik i mekanikës), nxënësi fiton "Maturën shtetërore profesionale" me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I

**Plani mësimor për drejtimin "Mekanik" Niveli I**

| Nr | Kodi | Lëndët dhe modulet mësimore | Niveli I Orët javore/vjetore | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Klasa 10** | **Klasa 11** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **14/15** (504/ 540) | **11/12** (374/ 408) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj 1 | 2 | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë) | (1) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 | 2 |
| 6 | | Fizikë | 2 | - |
| 7 | | Kimi | - | 2 |
| 8 | | Shkencat sociale | 2 | - |
| 9 | | Histori | - | 2 |
| 10 | | Gjeografi | 1 | - |
| 11 | | Teknologji informimi e komunikimi | 1 | - |
| 12 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 2 | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **10** (360) | **8** (272) |
| 1 | L-01-029-08 | Vizatim teknik | 3 | 2 |
| 2 | L-04-030-08 | Teknologji mekanike | 3 | 3 |
| 3 | L-04-031-08 | Mekanikë e zbatuar në makina | 2 | 1 |
| 4 | L-04-032-08 | Hidraulika e zbatuar | 2 | - |
| 5 | L-11-033-08 | Elektroteknikë dhe elektronikë | - | 2 |
| **C.** | | **Module të detyruara të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **5** (180) | **10** (340) |
| 1 | M-04-1404-18 | Punime axhusterie | 126 | - |
| 2 | M-04-091-18 | Punime mekanike të zmontim-montimit | 54 | - |
| 3 | M-04-1405-18 | Punime saldimi | - | 102 |
| 4 | M-04-094-11 | Punime në makina tornuese - 1 | - | 102 |
| 5 | M-04-095-08 | Punime në makina frezuese - 1 | - | 34 |
| 6 | M-04-096-11 | Punime në makina zdruguese - 1 | - | 36 |
| 7 | M-04-1406-18 | Ndërtimi i konstruksioneve metalike të thjeshta | | 33 |
| 8 | M-04-097-11 | Punime të mirëmbajtjes në makinat industriale | - | 33 |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar .** (Gjithsej) | **1** (36) | **2** (68) |
| 1 | M-04-098-08 | Ngjitja e metaleve | 36 | - |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | M-04-099-08 | Punime duralumini | 36 | - |
| 3 | M-31-1407-18 | Përgatitja e formës dhe zemrës për derdhjen e bokolës | 36 | |
| 4 | M-04-100-08 | Punime në stokatriçe | - | 68 |
| 5 | M-04-101-08 | Punimi i një stampe të thjeshtë | - | 68 |
| 6 | M-04-1408-18 | Punime në makina të ndryshme metalprerëse | | 68 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31** (1080/ 1116) | **31/32** (1054/ 1088) |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:
Në klasën 10, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)
Në klasën 11 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë provimi i praktikës profesionale + 1 javë për të dy provimet teorike, të kulturës së përgjithëshme dhe të teorisë profesionale).
Një javë mësimore ka jo më shumë 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit "Mekanik", niveli I.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional "Mekanik".
Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar ne drejtimin profesional "Mekanik", niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e mekanikës, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Mekanik", niveli I

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor "Mekanik", niveli I, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Vizatim teknik" (L-01-29-08). Kl. 10 - 108 orë dhe Kl. 11 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Vizatim teknik", kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës **"Vizatim teknik.", klasa 10**, nxënësit duhet:
- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimet e vizatimit teknik.
- Të kryejnë skica të llojeve të ndryshme.
- Të përdorin materialet dhe veglat e vizatimit për të kryer ndërtime të ndryshme gjeometrike, si dhe vizatime të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.
- Të kryejnë skica dhe vizatime detalesh të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare duke përdorur standardet për paraqitjet, vendosjen e përmasave dhe ato të paraqitjeve me prerje.
- Të ndërtojnë paraqitje aksonometrike të figurave dhe trupave gjeometrikë, të modeleve mësimorë dhe të detaleve të thjeshtë.
- Të bëjnë hapjen e sipërfaqeve të trupave gjeometrikë dhe të detaleve të thjeshtë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Vizatim teknik", kl 10 - 108 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Njohuri për vizatimet teknike | 2 orë |
| **Tema 2** | Skicimi (paraqitja me dorë të lirë) | 6 orë |
| **Tema 3** | Materialet, veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik | 4 orë |
| **Tema 4** | Ndërtimet gjeometrike kryesore | 9 orë |
| **Tema 5** | Shkrimi teknik | 6 orë |
| **Tema 6** | Paraqitjet me disa pamje. | 15 orë |
| **Tema 7** | Njohuri për vendosjen e përmasave | 9 orë |
| **Tema 8** | Skicat dhe vizatimet e detaleve | 12 orë |
| **Tema 9** | Paraqitjet me prerje. Prerjet e thjeshta. Seksionet | 12 orë |
| **Tema 10** | Prerjet e përbëra. | 9 orë |
| **Tema 11** | Paraqitjet aksonometrike. Aksonometria e figurave dhe trupave gjeometrike | 6 orë |
| **Tema 12** | Paraqitja aksonometrike e modeleve mësimorë dhe detaleve | 9 orë |
| **Tema 13** | Hapjet e sipërfaqeve | 9 orë |

- **Synimet e lëndës "Vizatim teknik", kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "**Vizatim teknik", klasa 11**, nxënësit duhet:
- Të paraqesin dhe shënojnë pjesët e filetuara të detaleve.
- Të lexojnë vizatimet e detaleve të bashkuar dhe të paraqesin në skica dhe vizatime bashkime me fileto, me kiaveta, me kunja, me perçina dhe me saldim.
- Të lexojnë vizatime të rrotave të dhëmbëzuara cilindrike dhe transmesioneve të tyre si dhe të kryejnë skica dhe vizatime të thjeshta të rrotave dhe transmesioneve me rrota të dhëmbëzuara cilindrike.
- Të lexojnë vizatimet ku paraqiten sustat dhe të kryejnë skica dhe vizatime të sustave kryesore.

- Të njohin dhe të përdorin paraqitjet specifike që përdoren në skicat dhe vizatimet e punës së detaleve (pamjet e pjesshme, pamjet ndihmëse, elementët e nxjerrë, marrëveshjet për paraqitjet, etj.).
- Të lexojnë vizatime të ndryshme pune dhe të kryejnë skica dhe vizatime pune të detaleve të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.
- Të lexojnë dhe të detalizojnë vizatime përmbledhëse të vështirësisë mesatare dhe të kryejnë vizatime përmbledhëse të thjeshta.
- Të lexojnë vizatime ndërtimi të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.
- Të lexojnë vizatime skematike të thjeshta dhe të vështitësisë mesatare.
- Të tregojnë rëndësinë e vizatimeve me kompjuter dhe programet përkatëse.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës ”Vizatim teknik”, kl 11- 68 orë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Paraqitja dhe shënimi i filetave në vizatim. | 6 orë |
| **Tema 2** | Paraqitja dhe shënimi i bashkimeve me fileto. | 4 orë |
| **Tema 3** | Paraqitja dhe shënimi i bashkimeve me kiaveta, me kunja dhe me perçina. | 4 orë |
| **Tema 4** | Paraqitja dhe shënimi i bashkimeve me saldim. | 5 orë |
| **Tema 5** | Paraqitja dhe shënimi i rrotave të dhëmbëzuara dhe transmesioneve me rrota të dhëmbëzuara | 6 orë |
| **Tema 6** | Paraqitja dhe shënimi i sustave në vizatim. | 2 orë |
| **Tema 7** | Pamjet bazë, pamjet e pjesshme, pamjet ndihmëse, elementët e nxjerrë dhe marrëveshjet për paraqitjet. | 6 orë |
| **Tema 8** | Skicat dhe vizatimet e punës së detaleve. Përmasat në skicat dhe vizatimet e punës së detaleve. | 6 orë |
| **Tema 9** | Shënimi në skicat dhe vizatimet e punës së detaleve i ashpërsive dhe veshjeve të sipërfaqeve, i përpunimeve termike dhe kimiko-termike. | 2 orë |
| **Tema 10** | Shënimi në skicat dhe vizatimet e punës së detaleve i tolerancave të përmasave dhe gjeometrike. Shënimi i tolerancave të përmasave në skicat dhe vizatimet e bashkimeve të detaleve. | 2 orë |
| **Tema 11** | Leximi i vizatimeve të punës së detaleve. | 3 orë |
| **Tema 12** | Vizatimet përmbledhëse, prerjet dhe përmasat në vizatimet përmbledhëse. Hartimi i vizatimeve përmbledhëse. | 6 orë |
| **Tema 13** | Leximi dhe detalizimi i vizatimeve përmbledhëse | 6 orë |
| **Tema 14** | Vizatimet e ndërtimit | 4 orë |
| **Tema 15** | Vizatimet skematike | 4 orë |
| **Tema 16** | Vizatimet me kompjuter | 2 orë |

**2. Lënda “Teknologji mekanike“ (L-04-030-08). Kl. 10 – 108 orë dhe Kl. 11 - 102 orë**

- **Synimet e lëndës “Teknologji mekanike“, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji mekanike“, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin dhe rëndësinë e teknologjisë mekanike.
- Të përshkruajnë llojet e materialeve që përdoren në industrinë mekanike dhe më gjerë .
- Të përshkruajnë vetitë kryesore të materialeve metalike dhe fushën e përdorimit të tyre.

- Të përshkruajnë proceset e prodhimit të gizës dhe çelikut si dhe ndryshimin ndërmjet tyre.
- Të përshkruajnë vetitë mekanike dhe teknologjike të metaleve.
- Të shpjegojnë ç'jane provat Brinel, Rokvell dhe Vikers.
- Të shpjegojnë ç'kuptojnë me strukturë të metaleve dhe cili është ndikimi i saj në vetitë e metaleve.
- Të përshkruajnë ndërtimin e diagramës Fe-C dhe përdorimin e saj.
- Të shpjegojnë ç'është giza, vetitë, llojet dhe përdorimin e saj.
- Të shpjegojnë ç'është çeliku, vetitë, llojet dhe përdorimin e tij.
- Të shpjegojnë ç'janë lidhjet e çelikut, vetitë, llojet dhe përdorimin.
- Të shpjegojnë ç'është trajtimi termik dhe si ndikon në vetitë e metaleve.
- Të përshkruajnë veçoritë e proceseve të ndryshme termike.
- Të përshkruajnë veçoritë e metaleve me ngjyra, të lidhjeve të tyre dhe përdorimin.
- Të përshkruajnë ç'është brejtja dhe si mund të mbrohemi prej saj.
- Të përshkruajnë ç'është derdhja, veçoritë e saj dhe kur përdoret.
- Të përshkruajnë ç'janë modelet, përse shërbejnë dhe si përgatiten.
- Të përshkruajnë mënyrën e përgatitjes së formave dhe të zemrave në procesin e derdhjes.
- Të përshkruajnë mënyrat speciale të derdhjes dhe rastet e përdorimit.
- Të përshkruajnë ç'është përpunimi plastik i metaleve, llojet e tij dhe veçoritë e secilës mënyrë.
- Të përshkruajnë ç'është saldimi, llojet e tij, veçoritë e secilës mënyrë saldimi, si dhe përdorimin e tij.
- Të përshkruajnë ç'është axhusteria, proceset që kryhen dhe veçoritë e secilit proces.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Teknologji mekanike", kl 10 – 108 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Hyrje në teknologjinë mekanike. | 2 orë |
| **Tema 2** | Metalet, klasifikimi, prodhimi dhe përdorimi i tyre. | 5 orë |
| **Tema 3** | Vetitë mekanike të metaleve dhe provat mekanike | 5 orë |
| **Tema 4** | Vetitë teknologjike të metaleve dhe provat teknologjike. | 5 orë |
| **Tema 5** | Struktura dhe procesi i kristalizimit të metaleve. Lidhjet metalike dhe diagrama Fe-C. | 5 orë |
| **Tema 6** | Çeliqet, klasifikimi, vetitë dhe përdorimi. | 2 orë |
| **Tema 7** | Gizat, klasifikimi, vetitë dhe përdorimi. | 2 orë |
| **Tema 8** | Përpunimi termik i metaleve, llojet dhe realizimi i tyre. | 2 orë |
| **Tema 9** | Përpunimi termik i çeliqeve | 3 orë |
| **Tema 10** | Përpunimi termik i gizave. | 2 orë |
| **Tema 11** | Çimentimi, azotimi dhe cianizimi | 2 orë |
| **Tema 12** | Përpunimi termik i çeliqeve të lidhura. | 2 orë |
| **Tema 13** | Njohuri për metalet me ngjyra dhe lidhjet e tyre. | 4 orë |
| **Tema 14** | Brejtja e metaleve dhe e lidhjeve të tyre. | 3 orë |
| **Tema 15** | Lidhjet e forta dhe materialet jometalike. | 4 orë |
| **Tema 16** | Njohuri të përgjithshme për prodhimin e detaleve me derdhje (fonderia). | 2 orë |
| **Tema 17** | Teknologjia e prodhimit të detaleve me derdhje. | 6 orë |
| **Tema 18** | Mënyrat speciale të derdhjeve. | 4 orë |
| **Tema 19** | Njohuri të përgjithshme për përpunimin plastik të metaleve. | 4 orë |
| **Tema 20** | Cilindrimi i metaleve. | 3 orë |
| **Tema 21** | Telëzimi i metaleve. | 2 orë |
| **Tema 22** | Shtrydhja e metaleve. | 2 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 23** | Farkëtimi i lirë. | 3 orë |
| **Tema 24** | Stampimi vëllimor. | 3 orë |
| **Tema 25** | Stampimi i fletëve. | 3 orë |
| **Tema 26** | Njohuri të përgjithshme për saldimin. | 2 orë |
| **Tema 27** | Saldimi me hark elektrik. | 4 orë |
| **Tema 28** | Saldimi elektrik me kontakt. | 2 orë |
| **Tema 29** | Saldimi me gaz. | 4 orë |
| **Tema 30** | Mënyra të veçanta saldimi. | 2 orë |
| **Tema 31** | Saldueshmëria e metaleve. | 3 orë |
| **Tema 32** | Prerja e metaleve me gaz dhe hark. Ngjitja e metaleve | 3 orë |
| **Tema 33** | Njohuri të përgjithshme për axhusterinë | 2 orë |
| **Tema 34** | Proceset kryesore të axhusterisë | 6 orë |

- **Synimet e lëndës "Teknologji mekanike", kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Teknologji mekanike", klasa 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ç'kuptojnë me saktësi të punimit mekanik dhe cilët janë parametrat që e përcaktojnë atë.
- Të shpjegojnë ç'kuptojnë me çiftëzime dhe të tregojnë shembuj nga praktika.
- Të shpjegojnë ç'është standardi i tolerancave ISO.
- Të përshkruajnë kush janë kriteret për realizimin e çiftëzimeve dhe të japin shembuj nga praktika .
- Të përshkruajnë veçoritë e tolerancave gjeometrike.
- Të shpjegojnë ç'është ashpërsia dhe ku qëndron ndikimi i saj.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta për përcaktimin e parametrave të një çifti detalesh.
- Të përshkruajnë ç'është matja, veçoritë e saj.
- Të përshkruajnë instrumentat matës dhe t'i përdorin ato.
- Të përshkruajnë instrumentat prerës të makinave tornuese dhe shpuese dhe të zgjedhin ato sipas procesit përkatës.
- Të përshkruajnë veçoritë e procesit të prodhimit dhe atij teknologjik.
- Të përshkruajnë makinat metalprerëse dhe qëllimin e tyre.Të përcaktojnë grupin përkatës.
- Të përshkruajnë gjeometrinë e instrumentave të makinave metalprerëse.(të thikës së tornos dhe të majave shpuese) dhe të përcaktojnë ndikimin e tyre në procesin e prerjes.
- Të përshkruajnë rregjimet e prerjes në makinat tornese dhe shpuese duke përcaktuar ndikimin e tyre në procesin e prerjes.
- Të përshkruajnë punimin e detaleve tipike në makinat tornuese.
- Të përshkruajnë punimin e filetove në makinat tornuese.
- Të përshkruajnë punimin e detaleve tipike në makinat shpuese.
- Të përcaktojnë rrugën e punimit në torno të një detali të thjeshtë duke përcaktuar instrumentin prerës dhe gjeometrinë e tij, si dhe regjimet e prerjes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Teknologji mekanike", kl. 11 – 102 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Saktësia e punimit mekanik të detaleve. Kuptimi për tolerancat e përmasave. | 3 orë |
| **Tema 2** | Çiftëzimet e detaleve. Standardi i tolerancave ISO | 4 orë |
| **Tema 3** | Llogaritja e parametrave të çiftëzimeve. | 3 orë |
| **Tema 4** | Saktësia e formës gjeometrike dhe e pozicionit të ndërsjelltë, mënyrat e shënimit. | 4 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 5** | Ashpërsia e sipërfaqeve. | 2 orë |
| **Tema 6** | Njohuri për matjet teknike dhe veglat matëse të thjeshta. | 2 orë |
| **Tema 7** | Kalibrat me tregues, përdorimi i tyre. | 3 orë |
| **Tema 8** | Mikrometrat, përdorimi i tyre. | 3 orë |
| **Tema 9** | Treguesit me fushë, përdorimi i tyre. | 3 orë |
| **Tema 10** | Pllakat etalon dhe kalibrat kufitar, përdorimi i tyre. | 3 orë |
| **Tema 11** | Këndmatësit, vizoret dhe sheshet e kontrollit, përdorimi i tyre. | 3 orë |
| **Tema 12** | Procesi i prodhimit dhe teknologjia e punimit të detaleve me prerje. | 5 orë |
| **Tema 13** | Elementet e regjimeve të prerjes. Procesi i krijimit të ashklës. | 3 orë |
| **Tema 14** | Thikat dhe gjeometria e tyre. Matja e këndeve të thikave. | 4 orë |
| **Tema 15** | Qëndrueshmeria e instrumentit prerës, faktorët që ndikojnë | 2 orë |
| **Tema 16** | Materialet për instrumentat metalprerës. | 2 orë |
| **Tema 17** | Forca, momenti dhe fuqia e prerjes. Përcaktimi regjimeve të prerjes me mënyrën tabelare | 2 orë |
| **Tema 18** | Njohuri për makinat metalprerëse (m.m.pr), skemat kinematike. | 3 orë |
| **Tema 19** | Mekanizmat tipike të makinave metalprerëse, ndërtimi dhe përdorimi. | 6 orë |
| **Tema 20** | Tornoja universale vidëprerëse | 3 orë |
| **Tema 21** | Vendosja e copave dhe instrumentave në makinat tornuese. | 3 orë |
| **Tema 22** | Punimet në makinat tornuese, llojet dhe veçoritë | 7 orë |
| **Tema 23** | Filetot dhe parametrat e tyre. | 2 orë |
| **Tema 24** | Filetimi në makinat tornuese, llojet dhe veçoritë. | 7 orë |
| **Tema 25** | Përgatitja e makinës tornuese për filetim. | 2 orë |
| **Tema 26** | Kontrolli i saktësisë së filetove. | 2 orë |
| **Tema 27** | Lloje të tjera makinash tornuese | 2 orë |
| **Tema 28** | Kontrolli i saktësisë së makinave tornuese | 3 orë |
| **Tema 29** | Makinat shpuese | 3 orë |
| **Tema 30** | Instrumentat shpuese. | 3 orë |
| **Tema 31** | Regjimet e prerjes në proçesin e shpimit. | 3 orë |
| **Tema 32** | Vendosja e copave dhe instrumentave në makinat shpuese. | 2 orë |

**3. Lënda "Mekanikë e zbatuar në makina" (L-04-031-08). Kl. 10 – 72 orë dhe Kl. 11 - 34 orë**

- **Synimet e lëndës "Mekanikë e zbatuar në makina", kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Mekanik e zbatuar në makina", klasa 10, nxënësit duhet:
- Të shpjegojnë qëllimin dhe rëndësinë e mekanikës së zbatuar në makina.
- Të shpjegojnë ligjet e lëvizjes së trupave .
- Të përshkruajnë lëvizjen drejtvizore të njëtrajtshme.
- Të bëjnë paraqitjen grafike të lëvizjes së njëtrajtshme.
- Të përshkruajnë lëvizjen e ndryshuar.
- Të bëjnë paraqitjen grafike të lëvizjes së ndryshuar.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta në gjetjen e "l", "u", "t" dhe "a" në lëvizjen e trupave.
- Të përshkruajnë lëvizjen rrethore të njëtrajtshme.
- Të përshkruajnë lëvizjen rrethore të ndryshueshme dhe të bëjnë dallimin me atë të njëtrajtshme.
- Të përshkruajnë lëvizjen e përbërë.
- Të shpjegojnë qëllimin e statikës.

- Të shpjegojnë ç'është forca, masa, brinjësitë përkatëse të tyre dhe të bëjnë dallimin midis tyre .
- Të shpjegojnë ç'janë forcat e përbëra dhe përse i studiojmë ato.
- Të zgjidhin grafikisht dhe analitikisht forcat e përbëra e të thjeshta.
- Të përshkruajnë kuptimin e momentit të forcës.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të përcaktimit të momentit.
- Të shpjegojnë ç'është momenti i një çifti forcash.
- Të shpjegojnë ç'është qëndra e rëndesës.
- Të përcaktojnë qëndrën e rëndesës të figurave të thjeshta.
- Të shpjegojnë përse shërbejnë teoremat e Guldinit dhe t'i zbatojnë ato.
- Të shpjegojnë ç'është ekuilibri i trupit të ngurtë, të bëjnë llogaritje të thjeshta të gjetjes së kundërveprimeve.
- Të shpjegojnë ç'është dinamika dhe përse e studiojmë.
- Të shpjegojnë ç'është fuqia dhe energjia mekanike.
- Të shpjegojnë ç'është energjia mekanike dhe cili është ndryshimi ndërmjet energjisë potenciale dhe asaj kinetike.
- Të shpjegojnë energjinë kinetike në lëvizjen tejbartëse.
- Të shpjegojnë lëvizjen kinetike në lëvizjen rrotulluese.
- Të shpjegojnë ligjin themelor të dinamikës për trupat që kryejnë lëvizje rrotulluese.
- Të shpjegojnë momentin dinamik dhe kinetik për lëvizjen rrotulluese.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të gjetjes së fuqisë dhe energjisë në mekanizma të thjeshta.

**Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Mekanika e zbatuar në makina", kl 10 – 72 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Hyrje në mekanikë dhe kinematikë. | 1 orë |
| **Tema 2** | Lëvizja drejtvizore e njëtrajtëshme. | 3 orë |
| **Tema 3** | Lëvizja e ndryshueshme. Rënia e lirë e trupave. | 5 orë |
| **Tema 4** | Lëvizja rrotulluese | 4 orë |
| **Tema 5** | Përbërja e lëvizjeve dhe zbatimi praktik i saj. | 4 orë |
| **Tema 6** | Kinematika e trupit të ngurtë. Lëvizja translatore (tejbartëse) | 2 orë |
| **Tema 7** | Hyrje në statikë. Forca dhe masa. | 4 orë |
| **Tema 8** | Përbërja e forcave. | 5 orë |
| **Tema 9** | Zbërthimi i forcave | 3 orë |
| **Tema 10** | Studimi i momenteve të forcave | 5 orë |
| **Tema 11** | Qendra e rëndesës, raste të ndryshme në trupat e ngurtë | 3 orë |
| **Tema 12** | Teorema e parë dhe e dytë e Guldinit | 3 orë |
| **Tema 13** | Zbatime të teoremave të Guldinit për qendrën e rëndesës së figurave të përbëra | 4 orë |
| **Tema 14** | Ekuilibri i trupit të ngurtë. Ekuacionet e ekuilibrit. | 6 orë |
| **Tema 15** | Zbatime të ekuacioneve të ekuilibrit të trupit të ngurtë | 4 orë |
| **Tema 16** | Njohuri të përgjithëshme për dinamikën. Energjia mekanike, llojet dhe njehsimi i tyre. Ligji i shndërrimit dhe i ruajtjes së energjisë. | 5 orë |
| **Tema 17** | Puna dhe fuqia mekanike, raste të ndryshme. | 3 orë |
| **Tema 18** | Energjia kinetike në lëvizjen translative (tejbartese) dhe rrotulluese. | 4 orë |
| **Tema 19** | Ligji themelor i dinamikës për trupat që bëjnë lëvizje rrotulluese. | 2 orë |
| **Tema 20** | Momenti dinamik dhe momenti kinetik për lëvizjen rrotulluese. | 2 orë |

- **Synimet e lëndës "Mekanikë e zbatuar në makina", kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Mekanikë e zbatuar në makina", klasa 11, nxënësit duhet:
- Të përshkruajnë ç'janë rezistencat pasive dhe ndikimin e tyre. Çështë fërkimi rrëshqitës si ndikon në punën e çiftit kinematik.
- Të shpjegojnë pse bëhet vajosja.
- Të shpjegojnë si shprehet puna dhe fuqia në fërkimin rrëshqitës
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të forcave të fërkimit te perni dhe te thundra.
- Të përshkruajnë ç'është fërkimi rrokullisës, cili është ndryshimi ndërmjet tij dhe atij rrëshqitës.
- Të përshkruajnë ç'janë kushinetat, si klasifikohen dhe ku përdoren.
- Të përshkruajnë ç'janë elementet e përkulshëm, veçoritë e tyre dhe ku përdoren.
- Të përshkruajnë ç'janë makinat e thjeshta dhe veçoritë e tyre.
- Të përshkruajnë ç'janë makinat e përbëra dhe veçoritë e tyre.
- Të tregojnë ndryshimin ndërmjet makinave të thjeshta dhe atyre të përbëra.
- Të tregojnë ç'është rendimenti i një makine dhe faktorët që ndikojnë.
- Të përshkruajnë rendimentin në çifte të ndryshme kinematike duke treguar veçoritë për seicilin.
- Të llogarisin renditin e një çifti të thjeshtë kinematik.
- Të përshkruajnë veçoritë e detaleve tipike dhe lidhjeve të tyre që përdoren në pajisjet dhe makina .

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Mekanikë e zbatuar në makina", kl. 11 – 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Njohuri për rezistencat pasive (fërkimi) dhe vajosjen. | 2 orë |
| **Tema 2** | Fërkimi rrëshqitës, zbatime të tij. Kushinetat rrëshqitëse | 4 orë |
| **Tema 3** | Fërkimi rrokullisës, zbatime të tij. Kushinetat rrokullisëse | 3 orë |
| **Tema 4** | Makinat e thjeshta. Leva dhe makaraja | 2 orë |
| **Tema 5** | Çikrikët, rrafshi i pjerrët, pyka dhe vidha. | 3 orë |
| **Tema 6** | Makinat e përbëra. Sistemet e levave, parankot dhe sisteme makarash të lëvizshme. | 3 orë |
| **Tema 7** | Lloje të tjera parankosh, çikrikët me rrota të dhëmbëzuara. | 2 orë |
| **Tema 8** | Ekuilibri dinamik i një makine. | 1 orë |
| **Tema 9** | Kuptimi për makinën, mekanizmin, dhe çftin kinematik. | 2 orë |
| **Tema10** | Rendimenti i makinave, raste të ndryshme. | 2 orë |
| **Tema11** | Rendimenti i çiftit vide-dado. | 2 orë |
| **Tema12** | Rendimenti i pernit, raste të ndryshme | 2 orë |
| **Tema13** | Frenat, llojet dhe veçoritë e tyre. | 2 orë |
| **Tema14** | Njohuri të përgjithëshme për detalet dhe lidhjet e tyre. | 4 orë |

**4. Lënda "Hidraulikë e zbatuar" (L-04-032-08). Kl. 10 - 72 orë**

- **Synimet e lëndës "Hidraulikë e zbatuar", kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Hidraulikë e zbatuar", klasa 10, nxënësit duhet:
- Të shpjegojnë qëllimin dhe rëndësinë e hidraulikës.
- Të shpjegojnë ligjet e hidrostatikës dhe rëndësinë e tyre.

- Të shpjegojnë ligjin e Paskalit.
- Të shpjegojnë ligjin e Arkimedit.
- Të zgjedhin aparatet e matjes së trysnisë.
- Të përshkruajnë veçoritë e ligjeve të hidrodinamikës dhe rëndësinë e tyre.
- Të përdorin aparatet matës të hidrodinamikës (tubi Pito, tubi Venturi, etj.)
- Të përshkruajnë humbjet hidraulike dhe shkaqet e lindjes së tyre.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të tubacioneve.
- Të përshkruajnë goditjen hidraulike.
- Të përshkruajnë pompat hidraulike.
- Të përshkruajnë ç'është kavitacioni dhe kur ndodh.
- Të përshkruajnë sistemet hidraulike.
- Të zgjedhin pompën hidraulike për një sistem të thjeshtë hidraulik.
- Të shpjegojnë transmesionet hidraulike.
- Të përshkruajnë transmesionin hidraulik të një makine të thjeshtë metalprerëse
- Të përshkruajnë turbinat hidraulike.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Hidraulika e zbatuar", kl 10 – 72 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Hyrje në hidraulikë, lëngjet dhe vetitë kryesore të tyre. | 3 orë |
| **Tema 2** | Hidrostatika, trysnia hidrostatike dhe llogaritje | 5 orë |
| **Tema 3** | Aparatet matëse të trysnisë | 2 orë |
| **Tema 4** | Ligji i Paskalit, zbatime të tij. | 3 orë |
| **Tema 5** | Ligji i Arkimedit. | 2 orë |
| **Tema 6** | Hidrodinamika, lëvizjet e lëngut | 3 orë |
| **Tema 7** | Ekuacionet e lëvizjes së lëngjeve | 4 orë |
| **Tema 8** | Aparatet matës të hidrodinamikës dhe përdorimi i tyre | 4 orë |
| **Tema 9** | Regjimet e lëvizjes së lëngut dhe përcaktimi i tyre | 4 orë |
| **Tema 10** | Humbjet hidraulike dhe përcaktimi i tyre | 4 orë |
| **Tema 11** | Rrjedhjet e lëngut në vrima, hundëza dhe tubacione. | 4 orë |
| **Tema 12** | Llogaritja e tubacioneve dhe goditja hidraulike. | 5 orë |
| **Tema 13** | Njohuri të përgjithshme për sistemet dhe pompat hidraulike. | 4 orë |
| **Tema 14** | Pompat qëndërikse, parimi i punës, ndërtimi dhe zgjedhja e tyre. | 6 orë |
| **Tema 15** | Pompat vëllimore, parimi i punës, ndërtimi dhe zgjedhja e tyre. | 4 orë |
| **Tema 16** | Njohuri të përgjithshme për transmesionet hidraulike | 5 orë |
| **Tema 17** | Mekanizmat e shpërndarjes së lëngut në sistemet hidraulike | 5 orë |
| **Tema 18** | Turbinat hidraulike | 5 orë |

## 5. Lënda "Elektroteknikë dhe elektronikë" (L-11-033-08). Kl. 11 - 68 orë

- **Synimet e lëndës "Elektroteknikë dhe elektronikë", kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Elektroteknikë dhe elektronikë" në kl. 11 nxënësit duhet:
- të përshkruajnë objektin e elektroteknikës dhe rëndësinë e saj për mekanikën;
- të tregojnë kuptimin e madhësive elektrike dhe simbolikën e tyre;
- të bëjnë dallimin midis përcjellësve dhe izolatorëve të rrymës elektrike;
- të përshkruajnë efektet kryesore të rrymës elektrike;
- të tregojnë rreziqet nga rryma elektrike dhe masat për mbrojtjen prej saj;
- të dallojnë elementet e ndryshëm të skemave elektrike tipike;





- të përshkruajnë veçoritë e skemave elektrike tipike;
- të zbatojnë ligjin e Omit në një pjesë të qarkut si dhe në qarqe elektrike të thjeshta;
- të zbatojnë ligjin Xhaul – Lenc.
- të shpjegojnë dukuritë e elektromagnetizimit dhe induksionit elektromagnetik;
- të përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mekanikë të elementeve kryesore të skemave elektrike.
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e transformatorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e motorëve sinkronë dhe asinkronë;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e gjeneratorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e akumulatorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë objektin e elektronikës dhe rëndësinë e saj për mekanikën;
- të tregojnë veçoritë dhe përdorimet e gjysëmpërçuesve në mekanikë;
- të dallojnë elementet e ndryshëm të qarqeve elektronike tipike dhe simbolikën e tyre;
- të përshkruajnë veçoritë e skemave tipike me gjysëmpërçues;
- të përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mekanikë të qarqeve të integruara dhe të printuara

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektroteknikë dhe elektronikë” kl. 11 - 68 orë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Hyrje në elektroteknikë | 2 orë |
| **Tema 2** | Madhësitë elektrike dhe matja e tyre | 3 orë |
| **Tema 3** | Përcjellësit dhe izolatorët e rrymës elektrike | 2 orë |
| **Tema 4** | Efektet e rrymës elektrike | 2 orë |
| **Tema 5** | Rreziqet dhe mbrojtja nga rryma elektrike | 2 orë |
| **Tema 6** | Elementet (simbolet) dhe llojet kryesore të skemave elektrike | 4 orë |
| **Tema 7** | Ligji i Ohmit, zbatime të tij. | 2 orë |
| **Tema 8** | Ligji i Xhaul - Lencit, zbatime të tij. | 2 orë |
| **Tema 9** | Elektromagnetizmi dhe induksioni elektromagnetik | 4 orë |
| **Tema 10** | Çelësat | 2 orë |
| **Tema 11** | Rezistencat | 2 orë |
| **Tema 12** | Bobinat | 2 orë |
| **Tema 13** | Kondensatorët | 2 orë |
| **Tema 14** | Ndriçuesit dhe sinjalizuesit | 3 orë |
| **Tema 15** | Frenat elektrike | 2 orë |
| **Tema 16** | Pajisjet treguese të parametrave | 2 orë |
| **Tema 17** | Pajisjet mbrojtëse (siguresat dhe automatët) | 3 orë |
| **Tema 18** | Pajisjet e komutimit, komandimit dhe rregullimit | 3 orë |
| **Tema 19** | Transformatorët | 3 orë |
| **Tema 20** | Motorët elektrikë, sinkronë dhe asinkronë | 4 orë |
| **Tema 21** | Gjeneratorët, llojet tyre | 3 orë |
| **Tema 22** | Akumulatorët | 2 orë |
| **Tema 23** | Hyrje në elektronikë | 2 orë |
| **Tema 24** | Gjysëmpërçuesit | 2 orë |
| **Tema 25** | Elementet e qarqeve elektronike | 3 orë |
| **Tema 26** | Skemat bazë me gjysëmpërçues | 3 orë |
| **Tema 27** | Qarqet e integruara dhe të printuara | 2 orë |

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Punime axhusterie”

**Drejtimi:** **Mekanik**
**Niveli:** **I**
**Klasa:** **10**

| *PERSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME AXHUSTERIE** | **M-04-1404-18** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme me vegla, instrumenta e pajisje axhusterie, në detale të paçiftëzuara dhe të çiftëzuara, si dhe për të prodhuar detale të thjeshta me punime axhusterie, duke kryer edhe matjet përkatëse. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 126 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe proçedurat e vlerësimit** | **RM 1** **Nxënësi kryen matje dhe shënime mekanike.**<br>***Përmbajtja:***<br>- Përzgjedhja e instrumentave matëse dhe shënuese.<br>- Matja me metër.<br>- Matja me kalibër.<br>- Matja me mikrometër.<br>- Matja me këndmatës.<br>– Shënimi me instrumenta shënuese.<br>– Kujdesi për instrumentat matëse dhe shënuese.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli.<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përzgjedhë drejt instrumentat matëse dhe shënuese.<br>- të kryejë matje të sakta me metër.<br>- të kryejë matje të sakta me kalibër.<br>- të kryejë matje të sakta me mikrometër.<br>- të kryejë matje të sakta me këndmatës.<br>– të bëjë shënimet e nevojshme me instrumenta shënuese të llojeve të ndryshme.<br>– të tregojë kujdesin e duhur për instrumentat matëse dhe shënuese.<br><br>**RM 2** **Nxënësi kryen punime të limimit të sipërfaqeve metalike, të brendëshme dhe të jashtme.**<br>***Përmbajtja:*** | |

- Analiza e skicës ose vizatimit të detalit metalik.
- Përzgjedhja e copës metalike për limim.
- Përzgjedhja e limave për limim.
- Përzgjedhja e instrumenteve matës dhe shënues gjatë limimit.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në morsë.
- Kryerja e limimeve të sipërfaqeve të rrafshta.
- Kryrja e limimeve të sipërfaqeve të profiluara
- Kryrja e limimeve të sipërfaqeve me kënd.
- Matja dhe shënimi gjatë limimit të sipërfaqeve përkatëse.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë limimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- të përzgjedhë copën metalike të përshtatshme për limim.
- të përzgjedhë limat e duhura për limimet që do të kryhen.
- të përzgjedhë instrumentet e duhura matëse dhe shënuese.
- të vendosë dhe shtrëngojë në mënyrë të rregullt copën në morsë.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të rrafshta.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve cilindrike.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të profiluara
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve me kënd.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë limimit të sipërfaqeve përkatëse.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë limimit.

**RM 3 Nxënësi kryen punime të prerjes së copave metalike me vegla dore.**

***Përmbajtja:***

- Analiza e skices ose e vizatimit të detalit metalik.
- Përzgjedhja e copës që do të pritet.
- Përzgjedhja e metodës për prerjen e copës.
- Përzgjedhja e veglave të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në pajisjen mbajtëse.
- Teknika e prerjes me sharrë metalike dore.
- Teknika e prerjes me gërshërë dore për fletë metalike.
- Teknika e prerjes me daltë.
- Teknika e prerjes me gur-fleksibël.

- Matjet dhe shënimet gjatë prerjes.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose e vizatimin e detalit metalik.
- të përzgjedhë copën e përshtatshme që do të pritet.
- të përzgjedhë metodën e duhur për prerjen e copës.
- të përzgjedhë veglat e duhura të punës.
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshme matëse dhe shënuese.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në pajisjen mbajtëse.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me sharrë metalike dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gërshërë për fletë metalike.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me daltë.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gur-fleksibël.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes.

**RM 4 Nxënësi kryen punime të detaleve metalike me deformim në të ftohtë, me vegla dore.**

***Përmbajtja:***

- Analiza e skices ose e vizatimit të detalit.
- Përzgjedhja e copës metalike.
- Përzgjedhja e mënyrës së deformimit që do të përdoret.
- Përzgjedhja e veglave të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në mbajtëse.
- Punimi i copës me anë të përkuljes me vegla dore.
- Punimi i copës me anë të shtypjes (rrahjes) me vegla dore.
- Punimi i copave prej fletësh metalike me anë të kthimit dhe palosjes së fletëve.
- Matja dhe shënimi gjatë punimit të detaleve me deformim në të ftohtë.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurisë teknike e të rujatjes së mjedisit gjatë punimit të detaleve metalike me deformim në të ftohtë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose e vizatimin e detalit.

– të përzgjedhë copën e duhur për punimin e detalit me deformim në të ftohtë.
– të përzgjedhë mënyrën e duhur të deformimit që do të përdoret.
– të përzgjedhë veglat e duhura të punës.
– të përzgjedhë instrumentet e duhura matëse dhe shënuese.
– të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në mbajtëse.
